



Duke u mbështetur në nenin 51 paragrafi 1 dhe nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 8,9,10,11,12 dhe 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL), NR.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë, nenit 12 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenit 32 dhe 34 dhe 53 të Statutit të Komunës së Klinës, Rregullores nenit 11 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve, me kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 020-327/2 të datës 23.03.2018 për Rishqyrtim të Vendimit të KK të dt.28.02.2018 o 1nr.060/1367- për respektim të Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 neni 6 paragrafi 7 dhe 8, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-te të rregullt të mbajtur më 27.04.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Komitetit për Komunitete

I

Rishqyrtohet, Vendimi për Ndryshim dhe Plotësim të Vendimit për Themelimin e Komitetit për Komunitete të miratuar me dt.28.02.2018 01Nr.060/1367, sipas Shkresës për Vlerësimin e ligjshmërisë nr. 020-327/2 të datës 23.03.2018 nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,

II

Vendimi si në pikën 1 në respektim të Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020, ndryshon në përbërjen e anëtarësisë me përfaqsim gjinor dhe ka këtë përbërje:

- 1.Zeqir Morina-PDK (Kuvendi)
- 2.Enver Gashi-LDK (Kuvendi)
- 3.Valmir Bacaj-AAK (Kuvendi)
- 4.Mihane Sahiti-egjiptase
- 5.Mire Rama-ashkali
- 6.Nexhmedin Gashi-rom
- 7.Suzana Smigiq-serbe

III

Komiteti përfshin në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, ndërsa anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në Komunë dhe përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit të Komuniteteve (neni 53 paragrafi 1 i LVL).

IV

Zgjedhja e anëtarëve të Komitetit për Komunitete bëhet me propozimin e kandidatëve të ofruar nga komuniteti jo shumicë.

V

Përbërja e anëtarëve të KPK-a është prej 7 anëtarëve të cilët kompensohen për punën e tyre.

VI

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete behët më shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

VII

Ky vendim shfuqizon vendimin e Kuvendit 01Nr.060-1367/2018 të miratuar me dt.28.02.2018

VIII

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në Autoritetin Mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-3258 2018
Klinë, më 04.05 2018



Kryesuesi,
Fadil Gashi